



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm Arsim kulturës, Rinisë
dhe sporteve

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr./datë 04/09/2025

Nr. _____ Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. Prot 3 datë 01/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e planit të arsimit parauniversitar

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

- Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipëri", i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Bulqize;
- Plani Social i Bashkisë Bulqize 2024–2026.

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Bulqize është një realitet i ndërthurur urban-rural, me 8 njësi administrative, Në Bashkinë Bulqizë shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njërive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Bulqizë funksionojnë 28 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Bulqizë është 26,826 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 13,608 meshkuj dhe 13,218 femra.

Në bashkinë Bulqize, kemi 25 kopshte që funksionojnë brenda shkollave, ndërkohë që kemi marr në analizë 28 kopshte publike. Të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor tregojnë se në total 53.93% e fëmijëve ndjekin kopshtin. Brenda këtij grupi, përqindja e përfshirjes ndryshon midis gjinive: 51.42% e djemve dhe 56.65% e vajzave janë të përfshirë në edukimin parashkollor. Ky ndryshim, tregon prirje që mund të ndikohen nga faktorë lokalë si infrastruktura, ndërgjegjësimi prindëror apo mundësitë ekonomike.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Financimi i planit do të mbështetet në burime të kombinuara nga buxheti vendor, transfertat specifike dhe të pakushtëzuara nga qeveria qendrore, si dhe nga bashkëpunimi me partnerë zhvillimi dhe donatorë.

**Drejtoria /
e arsimit
Sektori përgjegjës
arsimit**

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Prefekti, Keshilli

Impakti social / grupet që preken:

nxenesit, prinderit, qytetaret

A është objekt i konsultimit publik:

PO, është zhvilluar konsultimi publik Komisioni i Përhershëm për “ Arsimin kulturor, Rininë dhe Sportet ”, i mbledhur me datën 09/09/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr 03 Prot datë 01/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “ miratimin e planit të arsimit parauniversitar “ paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: (qarko njerën)
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit**
 - c) refuzimin e miratimit të projektaktit
 - d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

T'i propozojë Këshillit ndryshimet e projekt vendimit si më poshtë vijon te renditura me pika.

1.

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Arjan Hoxha Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Valbona Jani Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Maringela Dasi Anetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

_____ Anetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

_____ Anetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë 04/10/2025